

Programi: Banka Financa Kontabilitet

Studimet Bachelor

Punim diplome

**Vështrim analitik i potencialit kreditor në bankat  
komerciale në Kosovë – Rast studimi Raiffeisen Bank**

Mentori:  
Prof.asoc.dr.Qazim Tmava

Kandidatja:  
Gjejlane Nimani

Mitrovicë, 2023

## **MIRËNJOHJE DHE FALËNDERIME**

Fillimisht do të doja të falënderoja mentorin tim Prof. Dr. Qazim Tmava për udhëzimet, mbështetjen dhe ndihmën e vazhdueshme gjatë punimit të temës së diplomës. E vlerësoj gjithë kohën dhe mundin që ajo i ka dedikuar punimit të këtij projekti dhe gjithashtu kontributin për gjetjen e literaturës relevante.

Një falënderim i veçantë shkon edhe për familjen time, e cila më ka përkrahur në çdo aspekt gjatë studimeve universitare.

Do të doja të falënderoja edhe të gjithë profesorët të cilët më kanë përcjellë gjatë këtyre viteve të studimit për përkushtimin dhe ndikimin e tyre në rritjen time profesionale dhe akademike.

# TABELA E PËRMBAJTJËS

HYRJE .....	6
1.1. Qëllimi .....	6
1.2. Objektivat dhe detyrat e studimit; .....	6
1.3. Metodologjia; .....	7
KAPITULLI II .....	8
BANKAT KOMERCIALE NË KOSOVË .....	8
2.1. Sektori bankar në Kosovë .....	8
2.2. Shërbimet e bankave në Kosovë .....	9
2.3. Ndërmjetësimi financiar nga bankat komerciale.....	10
2.4. Kredit bankare dhe menaxhimi i tyre.....	13
2.5. Evoluimi i standardeve të kapitalit dhe risqeve bankare.....	14
KAPITULLI III.....	16
BAKNA RAIFFAISEN .....	16
3.1. Historiku i bankës Raiffasen .....	16
3.2. Funkzioni i bankës Raiffeisen Bank.....	18
3.3. Segmentet e biznesit dhe llojet e kredive ne bankën Raiffeisen Kosova.....	18
KAPITULLI IV. ....	22
REZULTATET E STUDIMIT.....	22
4.1. Të dhënat demografike mbi responentët.....	22
4.2. Prezantimi dhe interpretimi i rezultave të studimit.....	25
KAPITULLI V.....	30
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME .....	30
5.1. Përfundime.....	30
5.2. Rekomandime .....	32
BIBLOGRAFIA.....	33

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Të dhënat kryesore financiare në bankën Raiffeisen .....	21
Tabela 2. Paraqitja tabelare e moshës së pjesmarrësve në studim .....	22
Tabela 3. Paraqitja tabelare e vendbanimit së pjesmarrësve në studim .....	23
Tabela 4. Paraqitja tabelare e gjinisë së pjesmarrësve në studim .....	23
Tabela 5. Paraqitja tabelare e nivelit të arsimit të pjesmarrësve në studim .....	24
Tabela 6. A jeni të kënaqur me shërbimet e bankës Raiffeissen?.....	25
Tabela 7. A mendoni se janë të sigurta pagesat elektronike në banken Raiffeisen? .....	27
Tabela 8. A mendoni se qasja në kredi ndihmonë në kalibrimin e të ardhurave periodike me konsum të vazhdueshëm ? .....	28
Tabela 9. A jeni të kënaqur me transaksionet në banken Raiffeisen? .....	29

## LISTA E GRAFIKËVE

Grafikoni 1. Përdorimi i kredive biznesore.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Grafikoni 2. Kredite dhe paradhëniet për klientë .....	19
Grafikoni 3. Pjesëmarrja në treg me kredi dhe paradhënie.....	20
Grafikoni 4. Knaqësia nga shërbimet bankes Raiffaisen .....	25
Grafikoni 5. Kënaqësia nga kreditë dhe kushtet e saj në bankën Raiffasen .....	26
Grafikoni 6. Siguria tek pagesat elektronike.....	27
Grafikoni 7. Qasja në kredi.....	28
Grafikoni 8. Transaksionet elektronike.....	29

# **HYRJE**

Bankat, si ndermjetës financiar, janë një nga institucionet shumë të rëndësishme në cdo ekonomi. Bankat mundësojnë shpërndarjen e fondeve nga njesitë suficitare tek ato deficitare, dmth, mundesojne lëvizjen e mjetevefinanciare prej subjekteve te cilat kanë tepricë të mjeteve financiare tek ato që kanë mungesë të mjeteve, por që kanë ide inovative dhe investive.

Spektori bankar ne Kosovë, nder vite, ka treguar performmace te mire. Të gjithë indikatorët kanë rezultuar pozitiv dhe në rritje.

Andaj, me të drejt është llogaritur dhe llogaritet si storie e suksesit te ne.

Në mënyrë permanente, ky sektor ka pasur rritje te financimeve ekonomike, ka rritur kreditimin, depozitet kanë treguar përherë trend pozitiv, ka pasur ulje të normave te interest, si në depozite ashu edhe ne kredidhënje.

Në kudër te sektorit bankar në vend, pozitë shumë me redmnesi ka edhe banka Raiffhaissen, e cila është ndër bankat me afarizëm më të mirë nga të gjitha bankat komerciale, e cila për nga treguesit financiar, rezulton ndër më të fuqishmet.

Megjithatë, për të pasur një kreditim më të madh për sektorët që aktualisht kanë aksesin më i ulët në financimin bankar, përmirësimi i ofertës së kredisë nuk mjafton, përkundrazi është gjithashtu e nevojshme që kërkesa e këtyre sektorëve për kredi të jetë më e lartë dhe të cilësisë më të mirë.

## **1.1. Qëllimi**

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të analizojmë afarizmin e bankave komerciale dhe me fokus te veqant potencialin kreditor të bankave komerciale në Kosovë, konkretisht në Raiffaisen bank, si njëra nga bankat lidere në vend. Pra, që të analizohen parametrat kyq të kësaj banke, në kuadër të sistemit financiar dhe bankar, në vend.

## **1.2. Objektivat dhe detyrat e studimit**

Në kuadër të objektivave studimore, në këtë punim do të trajtohen objektivat vijuese:

Shqyrtmi i depoziteve te bankes, nder vite;

- Të shqyrtojë në literaturën teorike ekzistuese duke përzgjedhur artikujt që lidhen me studimin tonë të cilat shërbejnë për të kuptuar më thellë problemin dhe për të parë lidhjen midis studimit tonë dhe studimeve të tjera të realizuara.
- Të shqyrtoj kredidhenjen, nder vite;
- Të shqyrtoj levizjen e depoziteve, nder vite;
- Të shqyrtoj levizjen e normave të interesit si në depozite ashtu edhe në kredidhejnjë;
- Të shqyrtoj performancën financiare ndër vite, në banken Raiffaissen.
- Dhe në fund, të nxjerr konkluzione dhe ofroj rekomandime për akteret relevantë.

### **1.3. Metodologjia;**

Në punim është përdorur një metodologji bashkohore duke përdorur burime primare dhe sekondare.

Në kuadër të burimeve sekondare, janë përdorur të dhënat e publikuara nga vet banka në fjale, si dhe publikime vendore e ndërkombetare nga fusha e bankave dhe financave.

Ndërsa, nga burimet primare është përdorur Pyetsori i vetadministruar me 50 respondentë, të cilët janë klient në banken Raiffaissen. Mostra u nda në mënyrë të barabart 25 klient të gjinisë femërore dhe 25 të gjinisë mashkullore. Moshë e tyre sillet nga 18 deri 55 vjet.

Pyetsori-Instrumenti matës, kishte gjithësej 5 pyetje të tipit të mbyllur. Përgjigjet janë dhënë në 5 shkallë, sipas kategorizimit të shkallës së Likertit, duke filluar nga 1(*aspak dakord*) deri më 5 (*plotësisht dakord*).

Në kuadër të metodave të trajtuara janë përdorur metodat në vijim:

- Metoda historike (e cila mundeson krahasimin e të dhënave në dimensionin kohor)
- Metoda matematiko-statistikore (që mundësojnë analizën matematike-statistike të të dhënave)

-Metoda e analizës dhe sintezës ( që mundësojnë trajtimin e të dhënave ne menyre analitike dhe sintetike, ne menyre që të mund te nxjerrim konkluzione dhe japim rekomandime konkrete.)

## **KAPITULLI II**

### **BANKAT KOMERCIALE NË KOSOVË**

#### **2.1. Sektori bankar në Kosovë**

Banka është një industri që merret me para, kredi dhe transaksione të tjera financiare si për konsumatorët individualë ashtu edhe për bizneset. Banka siguron likuiditetin e nevojshëm për familjet dhe bizneset për të investuar në të ardhmen dhe është një nga shtytësit kryesorë të ekonomisë së Kosovës<sup>1</sup>.

Banka përbëhet nga shumë aktivitete që mund të kryhen përmes një sërë institucionesh financiare që pranojnë depozita nga individë dhe subjekte të tjera dhe më pas i përdorin këto para për të ofruar kredi dhe për të investuar dhe për të fituar fitim. Bankat mund të vendosen në kategori të caktuara në bazë të llojit të biznesit që ato kryejnë. Bankat komerciale ofrojnë shërbime për individët dhe bizneset private. Banka me pakicë ofron kredi, depozitat dhe menaxhimin e parave për individët dhe familjet<sup>2</sup>.

Sistemi bankar në Kosovë është një sektor i zhvilluar hovshëm në periudhen e pasluftes dhe filloi nga zeroja.

---

<sup>1</sup> (Ukaj, 2013)

<sup>2</sup> (Ukaj, 2013)



Aktualisht, Kosova përdorë euron si monedhë kombëtare edhe pse vendi nuk është anëtar i Eurozonës. Si i tillë, vendi nuk ka politikë monetare të pavarur. Sistemi bankar i Kosovës është i rregulluar mirë, fitimprurës dhe likuid. Banka Qendrore e Kosovës (BQK) është agjenci e pavarur publike me autoritet për të licencuar, mbikëqyrur dhe rregulluar institucionet financiare dhe kompanitë e sigurimeve në Kosovë. BQK-ja ka miratuar rregullat dhe rregulloret bankare në përputhje me Marrëveshjen e Bazelit dhe direktivat e BE-së.

Njëmbëdhjetë banka komerciale (2021), nëntë prej të cilave janë në pronësi të huaj, operojnë në Kosovë, duke përfaqësuar 66.6 përqind të gjithë asetëve në sektorin financiar. Bankat e huaja tregtare zënë rreth 85.8 përqind të totalit të aktiveve të sistemit bankar dhe dy banka vendase përbëjnë 14.2 përqind të mbetur. Fondet pensionale përfaqësojnë 26.5 përqind të asetëve të sistemit financiar, të ndjekura nga institucionet mikrofinanciare (4.1 përqind) dhe kompanitë e sigurimit (2.8 përqind). Në qershor 2022, asetet e sektorit financiar, duke përfshirë bankat, fondet e pensioneve, kompanitë e sigurimeve dhe mikrofinancat, arritën në 8.84 miliardë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej rreth 10.5 përqind. As sektori bankar dhe as ndërmarrjet tregtare lokale nuk janë mjaftueshëm të kapitalizuara për të financuar projekte të mëdha investimi. Në vitin 2021, investimet e reja të huazuara për ndërmarrjet përfaqësonin 57.2 përqind të totalit të kredive të reja të lëshuara gjatë asaj periudhe. Në vitin 2021, afërsisht 85.2 përqind e kredive bankare kanë maturitet mbi dy vjet, me maturitet nga dy deri në pesë vjet që përbëjnë 61.4 përqind të kredive. Afro 62.4 përqind e kredive i drejtohen ndërmarrjeve.

## **2.2. Shërbimet e bankave në Kosovë**

Janë njëmbëdhjetë banka që operojnë sot në sistemin bankar në Kosovë. Produktet dhe shërbimet të cilat i ofrojnë bankat komerciale në vend, janë të llojllojshme dhe përfshijnë: llogari bankare, kredi, marrje depoziti, pagesa vendase dhe ndërkombëtare, karta bankare, garanci bankare, letër kredie dhe e-banking.

Te sistemi i pagesave ndërbankare, i cili është një sistem modern, efikas dhe i sigurt, dhe regjistri i kredive që u ofron bankave shërbimet më moderne në këtë fushë shembuj të mirë për të ilustruar zhvillimin e infrastrukturës financiare në Kosovë.

Sektori bankar i Kosovës është në pozitë të shëndoshë financiare dhe me rritje të vazhdueshme të financimit të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të Kosovës. Kërkohej angazhim ndërinstitucional për të krijuar kushtet e nevojshme në që të jetë mbështetja e këtij sektori për ekonominë e vendit dhe për bizneset edhe më i madh. <sup>3</sup>

### **2.3. Ndërmjetësimi financiar nga bankat komerciale**

Institucioni qendror për kreditim në shkallë të gjerë ‘banka’ është pika e nisjes për çdo analizë të zhvillimit financiar për vendet në zhvillim. Për shkak se bankat luajnë këtë rol qendror në zhvillimin e ekonomive botërore, është e rëndësishme të shohim rolin e veçantë të bankave në ato vende. Roli themelor ekonomik i bankës është që të jetë një ndërmjetës midis kursimtarëve dhe përdoruesve përfundimtarë të kursimeve, të cilët investojnë ato kursime në aktivitete jofinanciare. Efikasiteti i transmetimit të kursimeve për ata përdorues përfundimtar është thelbësor për zhvillimin ekonomik. Përfundimi është i qartë se bankat nuk paraqesin vetëm probleme të veçanta të qeverisjes korporative, por në funksion të rolit qendror të bankave në ekonominë e shumë vendeve në zhvillim, një sfidë të veçantë paraqet rregullimi i kujdesshëm i veprimtarive bankare. Bankat mund të zvogëlojnë koston e marrjes dhe përpunimit të informacionit në lidhje me firmat dhe projektet e mundshme nga specializimi në vlerësimin e huamarrësve të mundshëm, në këtë mënyrë ndoshta duke rritur kursimet dhe akumulimin e kapitalit në ekonomi. Për më tepër, duke i identifikuar firmat dhe projektet më të denja, bankat rrisin nxitjen dhe ndarjen e burimeve. <sup>4</sup>

Një nga autorët e parë të mëdhenj, të cilët kuptuan rëndësinë e sistemit financiar në zhvillimin ekonomik, ishte Schumpeter (1928), duke studiuar procesin e inovacionit. Myrdal (1928), në anën tjetër, kur e përshkruan procesin e shkakut akumulues rrethor për të shpjeguar divergjencën në ecurinë e rritjes ekonomike të shteteve dhe rajoneve, po ashtu ka njohur edhe rolin e rëndësishëm që kanë bankat në procesin e zhvillimit.

Promovimi qeveritar i politikave bankare të konsolidimit në vend të mekanizmave të tregut ka qenë procesi i miratuar nga shumica e ekonomive në zhvillim dhe koha e konsolidimit të bankës ndryshon nga një komb në tjetrin. Reformat e industrisë bankare janë pjesë e instrumenteve të

---

<sup>3</sup> (Bannister, 2002).

<sup>4</sup> (Galindo & Micco, 2015)

politikës monetare për sistemet efektive dhe ndërrime të mëdha janë bërë në mekanizmat e transmetimit të politikës monetare në dekadën e fundit në kombet e zhvilluara dhe në zhvillim. Industria bankare në ekonomitë në zhvillim ka dëshmuar ndryshime të mëdha për të konkurruar për tërheqjen e investimeve ndërkombëtare dhe zhvillimin e tregut për rritjen e kapitalit. Shumë raste të konsolidimit bankar janë ndërmarrë në historinë moderne, si në Bashkimin Evropian dhe në SHBA në vitet 1980 dhe 1990. Nxitja e tregut të konsolidimit normalisht mban premtimet e ekonomisë së shkallës, fitimet e efikasitetit operacional, përmirësimin e përfitimit dhe krijimin e mekanizmave të burimeve financiare.<sup>5</sup>

Hagen, Dinger (2005) gjejnë se niveli i ulët i tanishëm i ndërmjetësimit bankar në EQL, të paktën pjesërisht, mund të shpjegohet me fazën e ulët fillestare të zhvillimit të industrive bankare të EQL-së. Duke krahasuar nivelet margjinale të ndërmjetësimit të vendeve të EQL-së me ato të vendeve të BE-së, ata konkludojnë se zënia e hapit me nivelet e BE-së është duke përparuar, të paktën në lidhje me aftësinë e bankave të EQL-së për të grumbulluar depozita. Lidhur me funksionin e kreditimit të industrive bankare, një prirje drejt afrimit me nivelet e BE-së do të mund të vërehet gjatë viteve të para të tranzicionit, por u ndërpre në fund të viteve 1990. Së dyti, duke i krahasuar tregjet kapitale të vendeve të EQL-së me ato të standardeve të BE-së, ne e refuzojmë hipotezën se zhvillimi i industrisë bankare ka qenë i pamjaftueshëm, sepse sistemet financiare janë duke u zhvilluar të bazuara në treg. Të dhënat tregojnë se tregjet e kapitalit në të gjitha vendet e EQL-së janë edhe më ashpër të pazhvilluara se industritë bankare. Prandaj, tregjet e kapitalit nuk mund të kompensojnë nivelin e ulët të ndërmjetësimit financiar të bankave.<sup>6</sup>

Košak, Čok (2008) studiuuan lidhjen midis pronësisë së bankës (e huaj vs vendase) dhe të performancës bankare në grup të përzgjedhur të gjashtë vendeve të EQL-së: Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, IRJ e Maqedonisë, Rumania, Serbia dhe Malit i Zi. Analiza ishte e bazuar në nivelin e bankave në nivel të industrisë dhe të dhënat makroekonomike për periudhën 1995-2004. Rezultatet e autorëve në pjesën e parë të analizës treguan vetëm një diferencim të kufizuar midis treguesve të performancës për bankat me pronësi të huaj dhe bankat e vendit, në të gjitha vendet. Dallimet më të theksuara midis bankave me pronësi vendase dhe të huaja janë zbuluar vetëm në treguesin e diferencës të interesit neto, ndërsa në treguesit e tjerë të performancës dallimet statistikisht të rëndësishme duket të jenë të rralla. Çdo dallim sistematik në barazinë e testimit për të dy

---

<sup>5</sup> (Aadi & Arback, 2013)

<sup>6</sup> (Adams, 1965).

nënperiudhat (1995-1999 dhe 2000-2004) nuk ishin të dallueshëm.<sup>7</sup>

Oman Khanlen (2012) shqyrtoi rolin e bankave në formimin e kapitalit dhe rritjen ekonomike në Nigeri për periudhën 1980-2009, duke përdorur modelin OLS. Rezultatet e modelit tregojnë se bankat komerciale kanë rol të rëndësishëm në formimin e kapitalit në ekonominë e Nigerisë. Kjo nënkupton se bankat komerciale kanë potencial për të rritur formimin e kapitalit kombëtar nëpërmjet bankave të tyre. Bankat komerciale, gjithashtu, kanë rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike të vendit. Kuptimi i kësaj është se vendi me industrinë bankare efektive mundëson rritje të shpejtë ekonomike, nëpërmjet aktiviteteve të biznesit të bankave.<sup>8</sup>

Zgjerimi i kreditimit të ekonomive familjare në vendet në tranzicion mund të jetë i lidhur me dominimin e bankave të huaja. Pasi mjedisi ligjor është në vend, kreditimi i ekonomive familjare është një mall biznesi që mund të futet lehtësisht përmes aplikimit të teknologjisë bankare nga jashtë vendit. Në të kundërt, huadhënia për ndërmarrjet kërkon zhvillimin e marrëdhënieve të klientit dhe kërkon të kesh aftësinë për të vlerësuar situatat unike, të cilat, të dyja, kërkojnë ekspertizë që përgjithësisht mungon në bankat e huaja. Në përgjithësi, rritja në industrinë bankare në vendet në tranzicion ka rritur ndjeshëm disponueshmërinë e shërbimeve financiare, shumë prej të cilave thjesht nuk kanë qenë të arritshme më parë. Shumë ndërmarrje të mëdha, veçanërisht në shtetet e reja anëtare të BE-së, janë në gjendje të përfitojnë nga rritjet e fundit në integrimet evropiane të tregut të kapitaleve dhe të marrin financime nga jashtë. Megjithatë, këto burime të financimit ranë me krizat globale të kreditimit, duke filluar në vitin 2007. Për më tepër, institucionet financiare jobankare po dalin në ekonomitë në tranzicion. Megjithatë, zgjerimi i shpejtë në disa vende është bërë një burim shqetësimi, për shkak të rritjeve shoqëruese potenciale me rrezik për industrinë bankare.<sup>9</sup>

Sipas Liebeg, Posch (2011) një nga pengesat e stimulimit të zhvillimit ekonomik është informacioni asimetrik (risku moral, zgjedhja e keqe) tek industria bankare. Një rast tipik i informacionit asimetrik është kur huadhënësi nuk ka informacione për huamarrësit dhe, në këtë rast, huamarrësit do të ndërmarrin projektet investuese me më shumë risk. Ky informacion asimetrik me rastin e dhënies së kredive mund të shpie deri te zgjedhja e keqe dhe risku moral. Informacion asimetrik tjetër është edhe garantimi i depozitave. Banka e cila ofron interesin më të lartë të depozitave tërheq më shumë klientë, por këta të fundit nuk kanë nxitjet e duhura për të

---

<sup>7</sup> (Hasan, Kotter, Lensink, & Meesters, 2018)

<sup>8</sup> (Anastasia & Anayouchuku, 2013)

<sup>9</sup> (Bannister, 2002)

monitoruar siç duhet aktivitetin e bankave dhe bankat në këtë rast janë të prirura për të ndërmarrë risqe. Sipas Mishkin dhe Eakins, mjetet të cilat ndihmojnë zgjidhjen e problemit të riskut moral janë: vlera neto e huamarrësit, mbikëqyrja dhe imponimi i klauzolave restriktive.

Sipas Calvo dhe Frenkel, vështirësitë në vlerësimin kreditor të ndërmarrjeve individuale mund të rezultojnë në një ekuilibër në të cilin investimet shoqërore afatgjata fitimprurëse janë shtyrë, ndërsa janë ndërmarrë ato investime afatshkurtra dhe më pak profitabile. Një ekuilibër i tillë mund të rrjedhë nëse huadhënësve potencialë u mungon besimi se huadhënësit e tjerë do të qëndrojnë të gatshëm të vazhdojnë në dhënien e kredive për të mbuluar nevojat e likuiditetit të ndërmarrjeve. Kjo mungesë e besimit mund të jetë veçanërisht e ngjarë në ekonomitë më parë të planifikuara nga qendra, pasi informacioni lidhur me karakteristikat e riskut të ndërmarrjeve të veçanta mungon ose nuk është gjerësisht në dispozicion për huadhënësit potencial. <sup>10</sup>

Rezultatet e autorëve hedhin dritë mbi debatin teorik mbi efektet e fuqisë së tregut të bankave në qasjen e firmave në kredi. Gjetjet ofrojnë dëshmi të kualifikuara për teoritë që përqendrohen në efektet negative të pushtetit bankar (hipoteza strukturë-performancë), ndërsa ato janë në kundërshtim me teoritë që theksojnë efektet e mundshme pozitive të përqendrimit bankar. <sup>11</sup>

## **2.4. Kredit bankare dhe menaxhimi i tyre**

Në përgjithësi, kreditë totale bankare mund të ndahen në: kreditë për sektorin privat dhe kreditë për sektorin publik. Është e provuar empirikisht se kredia për sektorin publik është e dobët në krijimin e rritjes brenda ekonomisë, për shkak se janë të prirur për humbje dhe programe të motivuara politikisht, të cilat nuk mund të japin rezultate më të mira.

Sipas Komisionit Evropian, shpërndarja e kredisë në Ballkanin Perëndimor (ELJ-6), në shumë raste, ishte e njëanshme ndaj konsumit sesa ndaj aktiviteteve prodhuese apo investimeve. Sektori i korporatave mbetet mbizotërues në stokun ekzistues të kredisë totale, por pjesa e saj ka rënë gradualisht: ajo ishte poshtë për vetëm rreth 44për qind në Kroaci dhe 55për qind në Maqedoni, në gjysmën e dytë të vitit 2008. Kjo tendencë, jo vetëm që dobëson kapacitetin afatgjatë të rritjes

---

<sup>10</sup> (Can, 2015)

<sup>11</sup> (Bannister, 2002)

ekonomike, por, gjithashtu, rrit riskun e ripagimit, si dhe rritjen e konkurrencës për ndarjen e tregut midis bankave, sidomos në segmentin e shitjes me pakicë ushtron presion mbi cilësinë e kredisë në portfolion e tyre.<sup>12</sup>

## **2.5. Evoluimi i standardeve të kapitalit dhe risqeve bankare**

Objektivi primar i standardeve të kapitalit është kontributi në sigurimin dhe shëndetin e sistemit financiar. Duke iu kërkuar bankave që të mbajnë kapital të mjaftueshëm për mbulimin e risqeve të tyre, standardet e kapitalit ndihmojnë në përgatitjen e bankave për mbijetimin e krizave dhe vështirësive ekonomike që ato mund të hasin. Me kohë, filloi edhe evoluimi i standardeve të kapitalit, nga Bazel I deri te Bazel III, aktualisht. Disa ndryshime u bënë për të reflektuar ndryshimet e sistemeve financiare, disa u bënë për të përmirësuar standardet e kapitalit dhe për të korriguar dobësitë e vërejtura pas zbatimit të tyre fillestar, përderisa disa të tjera u bënë për t'iu përgjigjur ndaj përpjekjeve të bankave për t'iu shmangur disa kufizimeve të qëllimshme të standardeve ekzistuese.<sup>13</sup>

Në korrik të vitit 1988, Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare – KBMB, përfundoi standardet e para ndërkombëtare të kapitalit për bankat me aktivitet ndërkombëtar, të cilat më vonë u bënë të njohura si Bazel I. Këto standarde paraqitën kornizën e matjes së riskut kreditor, e cila përfshinte zërat bilancorë të mjeteve dhe ekspozime të caktuara jashtë bilancore. Edhe pse Bazel I është dizajnuar për bankat me aktivitet ndërkombëtar, autoritetet mbikëqyrëse të shumë vendeve vendosën t'i aplikojnë ato më gjerësisht brenda kufijve të tyre. Bazel I ka tri elemente kryesore: 1) Definicionin e kapitalit rregullativ, ku instrumentet e kualifikuara si kapital ndahen në Kapital të Klasit të 1-rë ose Tier 1 (kualiteti më i lartë - ku përfshihet fitimi I pashpërndarë dhe kapitali aksionar) dhe Kapital të Klasës së 2-të ose Tier 2 (që përmbante instrumente të kapitalit me kualitet më të ulët). 2) Kategorizimin e mjeteve nëpër kategori standarde të peshimit të riskut, përmes së cilave ekspozimet ndaj riskut kreditor peshoheshin nga mbikëqyrësit bazuar në shkallën e tyre të riskut; dhe 3) (Aurangzeb, 2012). Dy raportet minimale të adekuatshmërisë së kapitalit që ndërlidhnin kapitalin me mjetet e peshuara në risk (RWA). Raporti i kapitalit të Klasit 1, minimum 4për qind dhe raporti total i Kapitalit rregullativ, minimum 8për qind. Duke nxjerrë mësimet nga

---

<sup>12</sup> (Anastasia & Anayouchuku, 2013)

<sup>13</sup> (Aurangzeb, 2012)

kriza në Azi, e cila tejkaloi limitet e caktuara me Bazel I, KBMB publikoi standardet e rishikuara në qershor 2004. Objektivi i këtyre standardeve ishte rritja e fushëveprimit, fleksibilitetit dhe kërkesat për kapital në varësi të nivelit të riskut, të njohura si “risk sensitive”. Me Bazel II u themeluan tri shtyllat kryesore të Bazelit, ku Shtylla I paraqet kërkesat minimale të kapitalit, të cilat janë më gjithëpërfshirëse për sa i përket mbulimit të tyre dhe më të ndjeshëm ndaj riskut sesa Bazel I. Me Bazel II paraqiten edhe kërkesat e kapitalit për riskun e tregut si dhe riskun operacional. Shtylla II paraqet procesin e rishikimit të mbikëqyrjes, e cila lejon adoptimin e kërkesave të kapitalit sipas specifikave të bankave. Kjo shtyllë, përveç disa specifikave të saj, u kërkon bankave të mbajnë kapital edhe për ato risqe të cilat nuk janë mbuluar me Shtyllën I (p.sh. koncentrimet e riskut) dhe Shtylla III, që përmban kërkesat për shpalosje dhe transparencë për të rritur disiplinën e tregut (Aurangzeb, 2012).

## **KAPITULLI III.**

### **BANKA RAIFFAISEN**

#### **3.1. Historiku i bankës Raiffasen**

Bankat e Grupit Raiffeisen datojnë në mesin e shekullit të 19-të, kur u shfaqën kooperativat e para dhe shoqëritë e huasë për të mbështetur fermerët në një kohë zie buke dhe krizë ekonomike.

Grupi Raiffeisen u themelua nga Friedrich Wilhelm Raiffeisen (1818-1888). Si kryetar i një numri fshatrash në provincën gjermane Westerwald në mesin e shekullit të 19-të, ai i përqendroi përpjekjet e tij në ndihmën e fshatarëve në luftën e tyre për mbijetesë, duke krijuar kooperativa bamirësie. Megjithatë, shpejt F. W. Raiffeisen e kuptoi se parimet e krishtera të bamirësisë nuk ishin mjaft efektive dhe se vetëndihma e organizuar do të ishte më e dobishme në arritjen e qëllimit të tij. Në 1862, ai themeloi kooperativën e parë bankare në Anhausen (Gjermani), e cila u bë një prototip për bankat Raiffeisen. Raiffeisenbank i parë u hap në Austri në 1886 dhe dhjetë vjet më vonë numri i përgjithshëm i bankave në Austri kishte arritur në 600. Sot, Raiffeisen Banking Group i Austrisë është më i fuqishmi në vend, me rrjetin më të madh bankar me pakicë dhe afërsisht një të katërtën e biznesit bankar vendas.

Friedrich Wilhelm Raiffeisen nuk ishte as hero dhe as revolucionar, por pothuajse çdo fshat apo qytet në Austri ka një Sheshin Raiffeisen ose Rrugën Raiffeisen. Një urë përtej Rhein është emëruar për nder të tij dhe ekziston një muze Raiffeisen në Weiherbusch. Emri i tij lidhet me organizatën që ai krijoi për të ndihmuar të tjerët.<sup>14</sup>

Në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të, mes reformave dhe rënies së regjimit të vjetër, konkurrenca u rrit në mënyrë dramatike dhe fermerët kishin nevojë të madhe për mjetet për t'u zhvilluar. Nuk kishte asnjë mbështetje nga qeveria apo huadhënësit privatë, normat e interesit të të cilëve ishin

---

<sup>14</sup> (<http://www.raiffeisenbank.ru/en/about/history/>).



jashtëzakonisht të larta për shkak të rreziqeve dhe shpenzimeve operacionale që lidhen me kreditë në shkallë të vogël. Friedrich Raiffeisen e njihte varfërinë nga dora e parë. Ai lindi më 30 mars 1818 në provincën gjermane të Westfalia në qytetin e vogël Hamm në familjen e një fermeri vendas (i shtati nga nëntë fëmijët). Kumbari i djalit, një prift, e ndihmoi atë të merrte shkollën fillore në përgatitje për një karrierë ushtarake. Megjithatë, në fillim të vitit 1842, ai u sëmur rëndë dhe shikimi i tij u dëmtua. Ai braktisi karrierën e tij ushtarake dhe mori një punë në qeverinë e qytetit të Koblenz. Për arritjet e tij, Friedrich Raiffeisen u emërua kryebashkiak i Weiherbusch dhe në 1845 u martua me Emily Stork, vajzën e një farmacisti Remagen.

Ashtu si shumë qytete të tjera në Evropën Qendrore, Weiherbusch jetonte në varfëri. Fermerëve dhe zejtarëve u mungonin mjetet për të jetuar dhe Raiffeisen i kuptonte problemet e tyre. Ai ishte i vetëdijshëm për teoritë e ndryshme utopike të përhapura në atë kohë, por i shihte ato si pak më shumë se era dhe tymi. Të afërmit dhe miqtë e Raiffeisen ishin ndër viktimat e varfërisë dhe vuajtjes, dhe ai kërkoi mënyra për t'i ndihmuar ata.

Në 1847 Raiffeisen përdori mjetet e tij modeste dhe donacionet nga të pasurit për të krijuar shoqëri huazimi për të ndihmuar bashkatdhetarët e tij të varfër. Megjithatë, shpejt u bë e qartë se një organizatë që synonte të mbështeste anëtarët e saj nuk mund të kishte sukses vetëm në bazë të kontributeve bamirëse. Raiffeisen mendoi se organizata duhet të bazohej në parimin e ndihmës së ndërsjellë midis anëtarëve të saj dhe kjo ide u bë themeli i kooperativave bujqësore: ata që kanë nevojë nuk duhet të mbështeten në donacionet private ose mbështetjen e qeverisë, por duhet të ndihmojnë veten dhe të tjerët duke krijuar sindikata. dhe kooperativat, të cilat do t'u jepnin gjithashtu mundësinë për të shitur produktet e tyre me kushte më të favorshme dhe për të konkurruar në treg. Raiffeisen themeloi bashkimin e parë të kreditit në 1846, duke ofruar shërbime bankare për anëtarët, duke ndihmuar njerëzit të konsolidojnë kursimet e tyre dhe duke u dhënë kredi anëtarëve me kushte të arsyeshme. Në 1872, në një përpjekje për të reduktuar rreziqet financiare dhe për të përmirësuar shkëmbimin e informacionit, Raiffeisen bashkoi sindikatat lokale si një bashkim rajonal kooperativ krediti. Një zyrë qendrore u hap në 1877.

Dy koka kuajsh të kryqëzuar u bënë emblema e Raiffensen; njerëzit e lidhnin këtë simbol në papafingo të shtëpive të tyre dhe besonin se i mbronte ata nga fatkeqësia. Kur Raiffeisen vdiq në 1888, kishte 425 shoqëri në Gjermani dhe rreth 120 në Austri të themeluara me përpjekjet e tij. Sistemi vazhdoi të zhvillohej dhe në shekullin e 20-të u themelua Grupi Raiffeisen, i udhëhequr nga Raiffeisen Zentralbank Oesterreich. Grupi hapi bankat e tij të para filialë në Evropën Qendrore

dhe Lindore në vitet 1980 dhe tani është një grup financiar lider në rajon. Raiffeisenbank punon në Rusi që nga viti 1996. Friedrich Wilhelm Raiffeisen vdiq më 11 mars 1888 dhe u varros në varrezat e Heddesdorf.<sup>15</sup>

### **3.2. Funkzioni i bankës Raiffeisen Bank**

Në bankën Raiffeisen Bordi Drejtuesve delegon përgjegjësinë për administrimin e riskut të kredisë tek Komiteti i Kreditimit të Bankës. Më pas një divizion i posaçëm për administrimin e riskut të kredisë është përgjegjës për mbikëqyrjen e riskut të kredisë duke përfshirë:

- Formulimin e politikave të kreditimit duke u këshilluar me njësitë bazë të biznesit;
- Themelimin e strukturës autorizuese për miratimin dhe ripërtëritjen e faciliteteve të kreditimit;
- Mbikëqyrjen dhe vlerësimin e riskut të kreditimit dhe të të gjitha ekspozimeve ndaj riskut të kredisë, që kalojnë kufirin e vendosur;
- Kufizimin e ekspozimit ndaj palëve, zonave gjeografike dhe industrive;
- Zhvillimin dhe përdorimin e sistemit të vlerësimit të rrezikut të Grupit në mënyrë, që të kategorizojë ekspozimin në bazë të shkallës së riskut të humbjeve financiare;
- Monitorimin e zbatimit të kufijve të miratuar për ekspozim të njësive të biznesit, duke përfshirë dhe ato për industrinë e zgjedhura, rrezikut të vendit dhe llojeve të produkteve.
- Sigurimin e këshillave, udhëzimeve dhe aftësi të specializuara njësive të biznesit për të zhvilluar praktikatat më të mira për administrimin e rrezikut të kreditimit në të gjithë Grupin.<sup>16</sup>

### **3.3. Segmentet e biznesit dhe llojet e kredive ne bankën Raiffeisen Kosova**

- Kredi personale:


---

<sup>15</sup> (<http://www.raiffeisenbank.ru/en/about/history/>)

<sup>16</sup> <https://www.raiffeisen-kosovo.com>)


- Kredi personale prej 1,000 € deri 20,000 €. (për klientët Premium shuma maksimale është 25,000 €
- Kredi express 200 € deri 5,000 €.
- Kredi studentore me shumë maksimale të kredisë prej 15,000 €
- Mbitërheqje/Overdraft: nëse klientëve të bankës iu duhen para të gatshme ata mund nëpërmjet bankës të bëjnë mbitërheqje prej dy pagave neto në çdo kohë.
- Kredi hipotekare:
  - Kredi për renovim: shuma e kredise prej 15,000€ deri ne 100,000 €
  - Kredi për blerje të truallit: shuma e kredisë është prej 15,000€ deri ne 200,000 €
  - Kredi hipotekare: shuma e kredise prej 15,000€ deri në 350,000 €

Totali i kredive bruto dhe paradhënieve të Bankës Raiffeisen në Kosovë deri më 31 dhjetor 2018 ishte 615.2 milionë euro (2017: 554 milionë euro). Pjesëmarrja në treg e bankës në kredi dhe paradhënie më 31 dhjetor 2018 ishte 22 përqind (2017: 22 %).



Grafikoni 1. Kredite dhe paradhëniet për klientët

(Burimi: Raiffeisen Bank, 2018)



Grafikoni 2. Pjesëmarrja në treg me kredi dhe paradhënie  
(Burimi: Raiffeisen Bank, 2018)

Nga grafikoni 3 shohim pjesmarrja në treg me kredi dhe paradhënje në bankën raiffaisen është 74% një përqindje shumë më e lartë se në bankat tjera e cila është 26.

Tabela 1. Të dhënat kryesore financiare në bankën Raiffeisen

<b>Banka Raiffeisen në Kosovë sh.a.</b>			
Vlerat monetare janë në milionë euro	2020	2019	Ndryshimi
<b>Pasqyra e të ardhurave</b>	<b>1/1-31/12</b>	<b>1/1-31/12</b>	
Të ardhurat neto pas provizioneve	38.1	37.3	2.2%
Të ardhurat neto nga tarifat bankare	9.4	10.3	-8.5%
Të ardhurat neto nga vlerësimi i instrumenteve financiare në vlerë të drejtë	0.1	0.1	-13.9%
Të ardhurat / shpenzimet nga tregtimi	(0.0)	0.1	-113.2%
Të ardhurat tjera operative	1.7	2.2	-21.0%
Shpenzimet e përgjithshme administrative	(30.8)	(29.4)	4.7%
Fitimi para tatimit	18.5	20.5	-9.9%
Fitimi pas tatimit	16.7	18.3	-8.9%
Fitimet për aksion	N/A	N/A	N/A
<b>Bilanci i gjendjes</b>			
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	28.6	35.5	-19.5%
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	709.5	669.5	6.0%
Depozitat dhe huamarrjet nga bankat	26.9	7.6	253.6%
Depozitat nga klientët	915.6	858.7	6.6%
Ekuiteti (përfshi interesat jo-kontrolluse)	144.1	127.4	13.1%
Gjithsej bilanci i gjendjes	1,116.0	1,021.9	9.2%
<b>Informatat vendore rregullative</b>			
Pasuritë e ponderuara sipas riskut B1	835.1	791.6	5.5%
Gjithsej fondet vetanake	145.9	128.0	14.0%
Gjithsej kërkesa për fonde vetanake	100.2	95.0	5.5%
Raporti i mbulimit tepricë	45.6%	34.7%	-5.8 PP
Raporti i kapitalit kryesor (klasi i parë)	15.7%	14.3%	-0.6 PP
Gjithsej raporti i fondeve vetanake	17.5%	16.2%	-0.7 PP
<b>Performanca</b>			
Kthimi në ekuitet (KE) para tatimit	14.5%	17.7%	-3.3 PP
Kthimi në ekuitet (KE) pas tatimit	13.1%	18.4%	-5.3 PP
Koeficienti kosto/të ardhura	54.1%	53.7%	0.4 PP
Kthimi në pasuri (KP) para tatimit	1.8%	2.2%	-0.4 PP
Raporti neto i provizionimit (Pasuritë mesatare të ponderuara sipas riskut B1 në librin e bankës)	1.4%	0.9%	0.5 PP

## KAPITULLI IV. REZULTATET E STUDIMIT

### 4.1. Të dhënat demografike mbi respondentët

Tabela 2. Paraqitja tabelare e moshës së pjesmarrësve në studim

		Frekuencat	Përqindja
Valid	18-25 vjet	11	22%
	26-35 vjet	10	20%
	36-45 vjet	21	42%
	46-55 vjet	8	16%
	Total	50	100%

**Mosha** – Në tabelen e më sipërme është paraqitur mosha e respondentëve të cilit i kishim për rast studimi, nga rezultatet shohim se shumica e respondentëve ishin të moshës 36-45 vjet, kurse të tjerët ishin 18-25 vjet 22%, 26-35 vjet 20% dhe 46-55 vjet 16%

Tabela 3. Paraqitja tabelare e vendbanimit së pjesmarrësve në studim

		Frekuencat	Përqindja
Valid	Qytet	40	80%
	Fshat	10	20%
	Total	50	100%

**Vendbanimi** – Në tabelen e më sipërme po shohim se mostra nga vendëbanimi në qytet ka një dominim të madh mbi mostren e vendëbanimit në fshat. 80% e respodentëve jetojnë në qytetet kurse vetëm 20% në fshat

Tabela 4. Paraqitja tabelare e gjinisë së pjesmarrësve në studim

		Frekuencat	Përqindja
Valid	Mashkull	25	50%
	Femër	25	50%
	Total	50	100%

**Gjinia** – Një nga qëllimet tona ishte që mostra të shtrihej në mënyrë të barabart si tek meshkujt ashtu edhe tek femrat, në atë mënyrë që mos të kemi diferenca gjinore. Në tabelen e më sipërme shihet 50% të mostres e përbëjnë femrat dhe 50% meshkujt.


Tabela 5. Paraqitja tabelare e nivelit të arsimit të pjesmarrësve në studim

		Frekuencat	Përqindja
Valid	Shkolla e mesme	5	10%
	Studime Bachelor	30	60%
	Studime Master	15	30%
	Total	50	100%

**Niveli i arsimit** – Po ashtu qëllim i yni ishte që respondentët të cilët i marim për studim të kenë nivele të ndryshme të arsimit prandaj mostra jonë përfshin 10% të pjesmarrësve që e kanë kryer shkollimin e mesem, 60% shkollimin bachelor dhe 30% shkollimin master.



## 4.2. Prezantimi dhe interpretimi i rrezultave të studimit




Grafikoni 3. Knaqësia nga shërbimet bankes Raiffissen

Tabela 6. A jeni të kënaqur me shërbimet e bankës Raiffaissen?

	Frekuancat	Përqindja	Statistikat	
Po	38	76%	Mesatarja	1.9200
Jo	8	16%	Mediana	2.0000
Nuk e di	4	8%	Modi	2.00
			Devijimi standard	0.48823

Nga rezultatet mund të shohim se shumica e pjesmarrësve të këtij studimi 76% janë përgjigjur me opsionin po në pyetjen a jeni të kënaqur me shërbimet bankare, 16% u përgjigjën me opsionin jo dhe 8% me opsionin nuk e di.

Mesatarja e përgjigjeve ishte 1.9200, mediana 2.0000, modi 2.00 dhe devijimi standard 0.48823




Grafikoni 4. Kënaqësia nga kreditë dhe kushtet e saj në bankën Raiffaisen

*Tabela 8. Ajeni të kënaqur me kreditë dhe kushtet e saj në banken Raiffaisen ?*

	Frekuencat	Përqindja	Statistikat	
Po	22	44%	Mesatarja	1.5100
Jo	23	46%	Mediana	2.0000
Nuk e di	5	10%	Modi	2.00
			Devijimi standard	0.64232

Në Kosovë bankat janë shumë të fekuentura edhe për shkak të kredive dhe responentët kanë pasur rastin të përgjigjen sa janë kënaqur ata me kre me kredit dhe kushtet e saj në banken Raiffaisen, nga përgjigjet e tyre dolën këto rrezultate: me opsionin po u përgjigjën 44%, me opsionin jo 46% dhe me opsionin nuk e di u përgjigjën 10% e responentëve.

Mesatarja është 1.5400, mediana 2.000, modi 2.00 dhe devijimi standard 0.64232.



Grafikoni 5. Siguria tek pagesat elektronike


Tabela 7. A mendoni se janë të sigurta pagesat elektronike në banken Raiffaisen?

	Frekuancat	Përqindja	Statistikat	
Po	32	64%	Mesatarja	1.6500
Jo	3	6%	Mediana	1.0000
Nuk e di	15	30%	Modi	1.00
			Devijimi standard	0.92145

Nga rezultatet në tabelen e më sipërme po shohim se 64% e responentëve mendojnë se pagesat elektronike në banken Raiffaisen janë të sigurta, kurse 6% e responentëve u përgjigjën me opsionin jo. Eshte interesant se me opsionin nuk e di u përgjigjën 30 e responentëve.

Mesatarja është 1.6500, mediana 1.0000, modi 1.00 dhe devijimi standard 0.92145.

A mendoni se qasja në kredi ndihmon në kalibrimin e të ardhurave periodike me konsum të vazhdueshëm ?




Grafikoni 6. Qasja në kredi

Tabela 8. A mendoni se qasja në kredi ndihmonë në kalibrimin e të ardhurave periodike me konsum të vazhdueshëm ?

	Frekuancat	Përqindja	Statistikat	
Po	21	42%	Mesatarja	1.9000
Jo	13	26%	Mediana	2.0000
Nuk e di	16	32%	Modi	1.00
			Devijimi standard	0.86307

Nga rezultatet në Raiffaisenelen e më sipërme po shohim se kemi të bëjmë me përgjigjje të ndryshme në pyetjen a mendoni se qasja në kredi ndihmonë në kalibrimin e të ardhurave periodike me konsum të vazhdueshëm. Nga rezultatet shihet se 42% e respondentëve u përgjigjën me opSIONIN po, me opSIONIN jo 26% kurse 32% e respondentëve u përgjigjën me opSIONIN nuk e di.

Mesatarja e përgjigjive për këtë pyetje është 1.9000, mediana 2.0000, modi 1.00 dhe devijimi standard 0.86307.



Grafikoni 7. Transaksionet elektronike

Tabela 9. A jeni të kënaqur me transaksionet në banken Raifaisen?

	Frekuancat	Përqindja	Statistikat	
Po	18	36%	Mesatarja	1.9600
Jo	16	32%	Mediana	2.0000
Nuk e di	16	32%	Modi	1.00
			Devijimi standard	0.82154

Përgjigje të përafërta për secilin opsion kanë dhënë respondentët në lidhje me kënaqshmërinë e tyre për transaksionet elektronike në bankën Raiffaisen, 36% e respondentëve janë të kënaqur me këto transaksione, 32% nuk janë të kënaqur dhe 32% janë përgjigjuar me nuk e di.

Mesatarja e përgjigjeve është 1.9600, mediana 2.000, modi 1.00 dhe devijimi standard 0.82154.

## **KAPITULLI V.**

### **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

#### **5.1. KONKLUZIONE**

Sistemi bankar në Kosovë llogaritet si storie e suksesit, në periudhën e pasluftës. Në fokus të kësaj teme është analiza e bankave komerciale me theks të veçantë në njerën nga bankat me të mëdha në vend siq është banka Raiffeisen.

Banka Raiffeisen operon në tregun bankar në Kosovë që nga viti 2003. Aktualisht, është ndër bankat lidere në tregun bankar në vend, duke ofruar produkte dhe shërbime të shumëllojshme dhe shumë cilësore. Në bazë të analizës së bërë SWOT, mund të konstatohet se kjo bankë është lider në treg, ka produkte të ndryshme, ka klientelë besnike, mundëson siguri të të dhënave, ka staf profesional, dhe ka shumë seriozitet në punën që e bënë. Mirëpo, gjatë analizës kemi konstatuar se banka edhe disa pika të dobëta, të cilat i specifikojmë në vijim: çmimet ende të larta në norma të interesit për kredi, tarifa të larta në mirëmbajtjen e llogarive, si dhe për provizionet të cilat i aplikon në rast të tërheqjeve të parave nga llogaria me anë të kartelave në ATM të cilat nuk janë klientë të bankës Raiffeisen. Përshkak të këtyre tarifave të larta, banka targeton një shtresë të caktuar të klientelës. Mundësitë e bankës janë për rritje në tregun bankar me pakicë- individual (retail banking) kjo sepse një pjesë e klientëve të bankës janë edhe moshë më e vjetër dhe ata dëshirojnë që të kryejnë shërbimet në sportele, pasi që ATMtë nuk janë aq praktikë për ta. Mundësi tjetër banka e ka rritjen e Raiffeisen Leasing pasi që si bankë janë numër një në vend, gjë që ju mundëson tërheqjen e klientëve. Banka gjithashtu e ka pjesën e ndërmjetesve të sigurimit (Insurance Broker), e cila ka mundësi për rritje. Me rritjen e kredive duhet të rritet edhe numri i përdorimit të tyre, pasi që ata janë më të mirët në fushën e konsultimit për sigurinë e kredive. Kërcënimet për bankën Raiffeisen janë bankat e tjera të cilat operojnë në tregun e Kosovës, bankat e reja që do të hyjnë në treg, si dhe institucionet mikrofinanciare. Të gjithë këta faktor janë kërcënime pasi që secili prej tyre ka produkte dhe shërbime me të cilat mund të ndikojnë në pjesën e tregut të bankës Raiffeisen. Banka Raiffeisen është institucion shumë serioz e që i ka nën kontrollë të gjitha risqet nga të cilat mund të sulmohet, prandaj vazhdimësia e punës të cilën e bënë në parandalimin e risqeve është gjëja të cilën duhet të vazhdojë ta bëjë. Të vazhdojë të jetë serioz, besnik dhe lider në tregun e Kosovës.

Nga analiza e deritanishme, bazuar në shqyrtimin e eliteratures dhe aktivitetit konkret të bankës në fjalë mund të nxirren edhe rekomandime konkrete, për një grup të gjerë akterësh: politikbërës, banka, institucione mikrofinanciare etj, por edhe për vet meaxhmentin e bankës Raiffeisen.

## 5.2. Rekomandime

Në vijim po japim disa rekomandime konkrete:

1. Në sistemin bankar aktualisht dominon një konkurrencë e madhe, (posaqërisht pas futjes së dy bankave të reja dhe aktualisht numri i tyre është 12 banka) andaj banka duhet të ketë kujdes rreth çmimit dhe tarifave dhe duhet të shqyrtoj mundësinë e uljes së tyre, nëse dëshiron që të ruan klientelën, por edhe që ta rrisë pjesëmarrjen në treg.
2. Banka duhet që të orjentojë edhe në klientet me të ardhura të rregullta personale dhe të krediton këto kategori, për shkak se janë tejet të sigurta dhe kthimi i mjeteve tregon rrezikshmëri të ultë.
3. Banka që të minimizon riskun dhe të ruan klientët, duhet që të synojë që analizat e aftësisë kreditore për klientet, të cilëve u bëhet analiza, t'i adreson në bazë të qarkullimit të kompanisë përmes bankës e të ulë vlerën e kërkesës për kolateral (qoftë peng apo hipoteke).
4. Dhe në fund, banka duhet që të synojë zgjerimin e gamës së produkteve dhe shërbimeve të sajë, posaqërisht atyre që nderlidhen me produkte të reja dhe inovative.



## BIBLOGRAFIA

- Aadi, R., & Arback, E. (2013). *Financial Development, Bank Efficiency and Economic Growth across the Mediteranean, MEDPRO*. Romania.
- Adams, J. (1965). *Inequity in social exchange*. San Diego: Academic press.
- Anastasia, C., & Anayouchuku, O. (2013). *Banks Credits: An Aid to Economic Growth in Nigeria*. Nigeria.
- Aurangzeb, T. (2012). *Contributions of Banking Sector in Economic Growth: A Case of Pakistan*. Pakistan.
- Bannister, D. (2002). *Transport Planning*.
- Can, O. (2015). *Work in Progress – Taking One for the Team: Goal Orientation and Gender-Related Task Division*.
- Galindo, A., & Micco, A. (2015). *Bank Credit to Small and Medium Sized Enterprises: the Role of Creditor Protection*. London.
- Hasan, I., Kotter, M., Lensink, R., & Meesters, A. (2018). *Bank Efficiency, Financial Depth, and Economic Growth*.
- Talbot, C. (2010). *Organizational and service improvement in the public service*.
- Tmava, Qazim (2022). *Roli i bankave ne menaxhimin e investimeve ne NVM-te kosovare*, punim doktorate ne doreshkrim, Univerziteti i Prishtines,
- Ukaj, F. (2013). *Marketingu në institucione financiare*. Prishtinë.
- Marrë nga: [https://www.raiffeisen-kosovo.com/Uploads/Data/Files/77/2021-04-29\\_RB\\_Kosovo2020\\_AR\\_AL\\_forwebpage\\_FINAL\\_4xKqMqfPap.pdf](https://www.raiffeisen-kosovo.com/Uploads/Data/Files/77/2021-04-29_RB_Kosovo2020_AR_AL_forwebpage_FINAL_4xKqMqfPap.pdf) Me dt. 20.05.2022
- Marrë nga: <https://www.investopedia.com/terms/c/commercialbank.asp> Me dt. 12.05.2022
- Marrë nga: <https://bqk-kos.org/> Me dt. 16.05.2022
- Marrë nga: <https://www.raiffeisen-kosovo.com/shq/rreth-nesh/banka-raiffeisen/historia-e-bankes/> Me dt. 21.05.2022
- Marrë nga: <https://www.raiffeisen-kosovo.com> Me dt. 20.05.2022

